

# EPOKA

# ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XXI, nr. 6228  
E hënë, 1 shkurt 2021  
çmimi 0.40 €

Në 24-vjetorin e rënies,  
përkujtohen Zahiri,  
Hakifi dhe Edmondi



Na ndiqni edhe në:

[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)

facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABRUCH GMBH  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

FLET PËR "EPOKËN E RE", XHAVIT HALITI

## JEMI MË TË MOBILIZUAR SE KURRË MË PARË, EDHE TË SIGURT PËR FITOREN E PDK-së



Nënkryetari i Partisë Demokratike i Kosovës (PDK), Xhavit Haliti, është shprehur i bindur për fitoren e kësaj partie në zgjedhjet e 14 shkurtit. Në këtë intervistë dhënë gazetës "Epoka e re", ai ka thënë se strukturat e kësaj partie janë mobilizuar më shumë se kurrë më parë. Sipas Halitit, ky mobilizim do ta sjellë fitoren e PDK-së më 14 shkurt. Haliti, i cili është edhe kandidat për deputet, ka hedhur poshtë rezultatet e sondazheve të publikuara deri më tani, duke thënë se ato janë të porositura

## SOT TËRHIQET SHORTI PËR RENDITJEN E PARTIVE POLITIKE

Sot (e hënë) do të organizohet tërheqja e shortit për renditjen e subjekteve politike në fletëvotimin e zgjedhjeve të 14 shkurtit. Pas tërheqjes së shortit për renditjen e partive politike më 3 shkurt pritet zyrtarisht të fillojë fushata zgjedhore e cila do të

zgasë deri më 12 shkurt. Në këto zgjedhje do të marrin pjesë 21 subjekte politike, dy koalicionet parazgjedhore dhe pesë iniciativa qytetare. KQZ-ja ka bërë me dije se numri i përgjithshëm i kandidatëve për këto zgjedhje është 1 079



KOSOVA REGJISTRON EDHE GJASHTË VIKTIMA  
DHE 287 RASTE TË REJA ME COVID

**RENOVA**  
PUTZ  
Macedoni  
Xhepçisht-Tetovë  
Gurëz-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
Fax: +389 44 487 200  
Mob: +377 44 501 289  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
MITROVICË

**Kolegji BIZNESI**  
www.kolegji.biznesi.com  
info@kolegji.biznesi.com  
038 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,  
E-mail: [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net) | [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net)

**INFINITY**  
Digital Agency  
Endrit Shaqiri  
+38344685122  
Internet Website,  
Marketing...

### OPINION

PËR MITROVICËN... F. 8

Shkruan: Bedri  
ISLAMI



NJË PËRSHKRIM  
I SHKURTËR PËR KAZERMËN  
USHTARAKE "BRANKO  
KRSMANOVIQ" NË PARAQIN F. 11

Shkruan:  
Lulzim SAHITI



### AKTUALE



VËRSHIMET E FUNDIT NË  
DRENAS MBULOJNË DISA URA  
DHE TOKA BUJQËSORE F. 10

### EKONOMI

NDËRTIMI I "AUTOSTRADËS SË  
PAQES", KËTË VIT F. 8

TRUSTI KUSHTËZON  
SHTETASIT E HUAJ PËR  
TËRHEQJEN E 10-PËRQINDËSHIT  
TË KURSIMEVE F. 9



### SPORT

LAÇI MPOSHT TEUTËN, SHEHU  
DEBUTON ME FITORE F. 12

## Bidenit i kërkohet të ndërhyjë në lirimin e një amerikani të rrëmbyer në Afganistan

UASHINGTON, 31 JANAR - Familjarët e Mark Frerichs, një kontraktori amerikan që është rrëmbyer nga një grup militant i lidhur me talibanët, po i bëjnë thirrje presidentit amerikan Joe Biden që të mos tërheqë trupa të tjerë nga Afganistani, nëse Frerichs nuk lirohet.

Familjarët dhe mbështetës të tjerë e kanë bërë këtë thirrje më 31 janar, që shënon edhe njëvjetorin e rrëmbimit të Frerichs.

Frerichs po punonte në projekte inxhinierike në Afganistan kur u rrëmbye. Zyrtarët amerikanë thonë se besojnë se ai po mbahet nga rrjeti Haqqani. Talibanët publikisht nuk e kanë pranuar se e kanë rrëmbyer këtë shtetas amerikan. "Ne jemi të bindur se ai është ende gjallë", tha motra e tij, Charlene Cakora, për "Associated Press". "Ne nuk mendojmë se ai është i vdekur apo është i lënduar", shtoi ajo.

Rrëmbimi i Frerichs është pjesë e një enigme më të madhe gjeopolitike, që synon që ta balancojë tërheqjen e forcave amerikane nga Afganistani me sigurimin e paqes dhe stabilitetit në rajon. Zyrtarët e administratës Biden kanë lënë të kuptohet se ata po e shqyrtojnë marrëveshjen që ShBA-ja ka arritur me talibanët, pas shqetësimeve se talibanët nuk po përmbushin zotimet e tyre që niveli i dhunës në Afganistan të bie.

Frerichs është një prej disa qytetarëve amerikanë që janë të rrëmbyer.

Paul Overby, një autor 78 vjeç nga ShBA-ja, më 2014 u zhduk nga provinca Khost që gjendet në kufi me Pakistanin. Ai ishte duke kryer hulumtim për një libër të tij. Gruaja e tij kishte thënë se në kohën kur u zhduk, Overby kishte planifikuar që ta kalonte kufirin për në Pakistan për të realizuar një intervistë me kreun e rrjetit Haqqani.



Departamenti amerikan i Shtetit ka ofruar pesë milionë dollarë shpërblim për këto që ofron informacione për vendodhjen e Frerichs dhe Overby.

Një tjetër shtetas amerikan që besohet se është rrëmbyer jashtë vendit është Austin Tice,

i cili u zhduk në Siri më 2012. Po ashtu, pjesëtari i marinës amerikane, Tevor Reed dhe shtetasi Paul Whelan gjenden të burgosur në Rusi.

Disa ditë para se Bideni ta merrte detyrën e presidentit, administrata paraprake e Donald Trumpit kishte njoftuar

se do ta shkurtonte numrin e trupave në Afganistan në rreth 2 500, si pjesë e një plani për tërheqjen e të gjitha trupave të ShBA-së, që është planifikuar të ndodhë në muajin maj. Por, i mbetet administratës Biden që të vendosë se si do të veprojë për këtë plan.

## Ekipi i OBSH-së viziton tregun në Vuhan ku u paraqitën rastet e para me Covid

GJENEVE, 31 JANAR - Ekspertët e Organizatës Botërore të Shëndetësisë (OBSH) që po hetojnë origjinën e koronavirusit, kanë vizituar të dielën një treg në Vuhan, ku u raportuan rastet e para me sëmundjen Covid-19 një vit më parë.

Ekipi i OBSH-së arriti në tregun e kafshëve Huanan që është mbyllur që prej janarit të vitit të kaluar dhe rojet nuk lejuan persona të tjerë që të hynin, raporton AFP.

Ky hetim i OBSH-së që u pengua nga Kina që të zhvillohej më herët ka për qëllim që të zbulojë se si



koronavirusi kaloi nga kafshët te njeriu.

Por, zyrtarët e OBSH-së, që janë në fazën e parë të hetimit, kanë minimizuar pritjet se

mund ta gjejnë burimin e virusit që ka vlarë mbi dy milionë persona në mbarë botën dhe ka goditur rëndë ekonominë globale. Ekipi i

OBSH-së, që të dielën arriti në tregun Huanan, po monitorohet nga autoritetet kineze.

Më herët gjatë javës, media shtetërore "Global Times" në një raportim ka minimizuar pretendimet e hershme se tregu Huanan ishte epiqendra e virusit, duke pretenduar se "hetimet e bëra më vonë" kanë sugjeruar se tregu nuk ishte burimi i shpërthimit të virusit.

Fillimisht, zyrtarët kinezë kishin thënë se kafshët që shiteshin në këtë treg me gjasë janë burim i shpërthimit të pandemisë. Por, më pas faji u

është lënë kafshëve të importuara dhe Kina, pa dhënë prova, ka thënë se burimi i shpërthimit mund të jetë diku tjetër.

Kina ka raportuar 4 636 të vdekur nga koronavirusi i ri dhe ka thënë se për shkak të veprimeve të ndërmarra, ekonomia e saj tashmë ka nisur rikuperimin nga pandemia.

Kina është kritikuar se fillimisht ka minimizuar shpërthimin e virusit dhe nuk ka dhënë informacione të plota kur rastet e para me Covid-19 u shfaqën në Vuhan në dhjetor të vitit 2019.

## Merkeli u kërkon gjermanëve durim dhe respektim të masave kundër Covidit

BERLIN, 31 JANAR - Kancelarja gjermane Angela Merkel e ka përshkruar krizën e koronavirusit si "përpyetje e madhe" për familjet që po përballen me masa izoluese, teksa ka bërë thirrje për durim. "Ne nuk jemi ende gati që t'i rihapim çerdhet dhe shkollat", ka thënë ajo në një video të publikuar. "Por, nëse jemi më konsistentë tani që të përmbahemi nga kontaktet dhe ta mbajmë distancën, t'i respektojmë rregullat e higjienës dhe mbajtjes së maskës, kjo (rihapja) do të ndodhë më shpejt", ka

deklaruar Merkel.

Pavarësisht se tha që po bëjnë gjithçka për t'i rihapur çerdhet dhe shkollat, kancelarja Merkel paralajmëroi kundër "rrezikut të mutacioneve shumë ngjitëse të virusit". Këto komente të Merkelit vijnë pasi lideri i bllokut konservativ të Merkelit në Parlamentin gjerman, Ralph Brinkhaus, tha se izolimi duhet të zgjatet përtej datës 14 shkurt.

Ministrat e Shëndetësisë të landeve gjermane është paraparë të takohen të shtunën për të diskutuar lidhur me fushatën e vaksinimit kundër

koronavirusit.

Qeveria federale është përballur me kritika për procesin e ngadalshëm të vaksinimit kundër koronavirusit.

Sipas të dhënave të Institutit "Robert Koch", të shtunën u raportuan 12 321 raste të reja me koronavirus. Gjermania aktualisht është duke zbatuar masën e izolimit, ku janë mbyllur kafiteritë dhe restorantet, shumë dyqane dhe institucionet e sistemit arsimor. Këto masa pritet të jenë në fuqi deri në mesin e muajit shkurt.



FLET PËR "EPOKËN E RE", XHAVIT HALITI

# Jemi më të mobilizuar se kurrë më parë, edhe të sigurt për fitoren e PDK-së



**"Epoka e re":** Mirëpo shumëkush po thotë se gara zgjedhore e 14 shkurtit është garë për vend të dytë?

**Haliti:** Jo, nuk është e vërtetë kjo. Ne si PDK po bëjmë fushatë për të dalë në vend të parë në këto zgjedhje. Për vend të dytë nuk jemi as duke menduar e as duke punuar. Me punën që po bëjmë dhe entuziazmin që po shoh në terren, besoj fort se vendin e parë e kemi të garantuar në këto zgjedhje.

**"Epoka e re":** Por sondazhet po e nxjerrin Lëvizjen Vetëvendosje fituese të këtyre zgjedhjeve. Cili është vlerësimi juaj për këto zgjedhje?

**Haliti:** Unë nuk jam specialist i sondazheve, por po flas për atë që kam parë në terren. Dhe ajo që kam parë në këto takime në terren del se ato sondazhe janë të stisura dhe janë sondazhe të porositura. Deri më tani dihet se cilat janë kompanitë serioze të sondazheve. Kur të dalin sondazhet e tyre, atëherë mund të flasim se cila është situata.

Nënkryetari i Partisë Demokratike i Kosovës (PDK), Xhavit Haliti, është shprehur i bindur për fitoren e kësaj partie në zgjedhjet e 14 shkurtit. Në këtë intervistë dhënë gazetës "Epoka e re", ai ka thënë se strukturat e kësaj partie janë mobilizuar më shumë se kurrë më parë. Sipas Halitit, ky mobilizim do ta sjellë fitoren e PDK-së më 14 shkurt. Haliti, i cili është edhe kandidat për deputet, ka hedhur poshtë rezultatet e sondazheve të publikuara deri më tani, duke thënë se ato janë të porositura

garojnë për vend të dytë në këto zgjedhje. "Jo, nuk është e vërtetë kjo. Ne si PDK po bëjmë fushatë për të dalë në vend të parë në këto zgjedhje. Për vend të dytë nuk jemi as duke menduar e as duke punuar. Me punën që po bëjmë dhe entuziazmin që po shoh në terren, besoj fort se vendin e parë e kemi të garantuar në këto zgjedhje", ka thënë Haliti. Haliti ka kritikuar sondazhet e publikuara deri më tani. Sipas tij, ato janë sondazhe të porositura dhe nuk janë reale. "Unë nuk jam specialist i sondazheve, por po flas për atë që kam parë në terren. Dhe ajo që kam parë në terren del se ato sondazhe janë të stisura dhe janë sondazhe të porositura. Deri më tani dihet se cilat janë kompanitë serioze të sondazheve. Kur të dalin sondazhet e tyre, atëherë mund të flasim se cila është situata", është shprehur Haliti. Ai ka folur edhe për ndikimin që do të kenë në këto zgjedhje mungesa e ish-presidentit Hashim Thaçi dhe ish-kryetarit të PDK-së, Kadri Veseli. "Partia Demokratike e Kosovës po hyn

në këto zgjedhje në kushte të jashtëzakonshme për shkak të situatës nga Gjykata Speciale. Edhe ne vetë zyrtarët e lartë të PDK-së kemi pasur një stres dhe një mendim se pa z. Veseli dhe pa z. Thaçi në Kosovë do të jetë vështirë për të shkuar në zgjedhje, mirëpo tani po shoh se PDK-ja, strukturat dhe aktivistët e saj janë mobilizuar më tepër se çdoherë. Dhe jam shumë i bindur se ky mobilizim do të ndikojë që zgjedhjet t'i fitojë Partia Demokratike e Kosovës", është shprehur Haliti.

**"Epoka e re":** Z. Haliti, prej shpalljes së zgjedhjeve keni filluar aktivitetet elektorale në terren. Si po ju shkon parafushata?

**Haliti:** Ne si Parti Demokratike e Kosovës jemi duke i vizituar strukturat e partisë, sepse fushata nuk ka filluar ende zyrtarisht. Këto aktivitete po shkojnë mirë dhe përgatitjet i kemi bërë të mira. Gjithashtu, pritjet për këto zgjedhje janë edhe më të mira. Ne po punojmë që të jemi partie e parë në zgjedhjet e 14 shkurtit.

**"Epoka e re":** Është hera e parë që PDK-ja po shkon në zgjedhje duke mos pasur në Kosovë as liderin historik dhe as liderin aktual. Sa sfiduese do të jenë këto zgjedhje për PDK-në?

**Haliti:** Partia Demokratike e Kosovës po hyn në këto zgjedhje në kushte të jashtëzakonshme për shkak të situatës nga Gjykata Speciale. Edhe ne vetë zyrtarët e lartë të PDK-së kemi pasur një stres dhe një mendim se pa z. Veseli dhe pa z. Thaçi në Kosovë do të jetë vështirë për të shkuar në zgjedhje. Mirëpo tani po e shoh se PDK-ja, strukturat dhe aktivistët e saj janë mobilizuar më tepër se çdoherë. Dhe jam shumë i bindur se ky mobilizim do të ndikojë që zgjedhjet t'i fitojë Partia Demokratike e Kosovës.

**"Epoka e re":** Domethënë, mungesa e z. Thaçi dhe z. Veseli e ka mobilizuar elektoratin e kësaj partie?

**Haliti:** E thashë edhe më lart, jemi të mobilizuar si kurrë më parë dhe jemi të sigurt për fitoren e PDK-së më 14 shkurt.

**EPOKA E RE**

Muhamet KOCI

PRISHTINË, 31 JANAR - Nënkryetari i Partisë Demokratike i Kosovës (PDK), njëherësh edhe kandidat për deputet, Xhavit Haliti, ka bërë me dije se strukturat e PDK-së janë duke punuar që kjo parti në zgjedhjet e 14 shkurtit të dalë subjekti i parë politik në vend. Ai ka thënë se strukturat e kësaj partie dhe elektorati janë mobilizuar si asnjëherë më parë.

Në këtë intervistë dhënë

gazetës "Epoka e re", Haliti është shprehur i bindur në fitoren e PDK-së më 14 shkurt. "Ne si Parti Demokratike e Kosovës jemi duke i vizituar strukturat e partisë, sepse fushata nuk ka filluar ende zyrtarisht. Këto aktivitete po shkojnë mirë dhe përgatitjet i kemi bërë të mira. Gjithashtu, pritjet për këto zgjedhje janë edhe më të mira. Ne po punojmë që të jemi partie e parë në zgjedhjet e 14 shkurtit", ka deklaruar ai.

Haliti ka mohuar pretendimet se PDK-ja dhe LDK-ja po

hyn



LËVIZJA VETËVENDOSJE, ALEANCA PËR ARDHMËRINË E KOSOVËS (AAK) DHE NISMA SOCIALDEMOKRATE (NS) NUK NDRYSHOJNË RENDITJEN E KANDIDATËVE NË LISTAT ZGJEDHORE

# Sot tërhiqet shorti për renditjen e partive politike

Sot (e hënë) do të organizohet tërheqja e shortit për renditjen e subjekteve politike në fletëvotimin e zgjedhjeve të 14 shkurtit. Pas tërheqjes së shortit për renditjen e partive politike më 3 shkurt, pritet zyrtarisht të fillojë fushata zgjedhore e cila do të zgjasë deri më 12 shkurt. Në këto zgjedhje do të marrin pjesë 21 subjekte politike, dy koalicione parazgjedhore dhe pesë iniciativa qytetare. KQZ-ja ka bërë me dije se numri i përgjithshëm i kandidatëve për këto zgjedhje është 1 079

**EPOKA  
ERE** **Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 31 JANAR - Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) sot (e hënë) do ta organizojë tërheqjen e shortit për renditjen e subjekteve politike në fletëvotimin e zgjedhjeve të 14 shkurtit. Lajmin e ka bërë me dije zëdhënësi i KQZ-së, Valmir Elezi. "Ju njoftoj se

nesër (e hënë, 1 shkurt, ora 10:00) Komisioni Qendror i Zgjedhjeve organizon tërheqjen e shortit për renditjen e subjekteve politike në fletëvotimin e zgjedhjeve të parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, të cilat do të mbahen më 14 shkurt 2021", ka thënë ai.

Pas tërheqjes së shortit për renditjen e partive politike, më

3 shkurt zyrtarisht do të fillojë fushata zgjedhore për zgjedhjet e 14 shkurtit, e cila do të zgjasë deri më 12 shkurt. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka njoftuar se është duke pritur aplikimet për akreditimin e vëzhguesve për zgjedhjet e parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës të cilat do të mbahen më 14 shkurt 2021. KQZ-ja ka

bërë me dije se afati për akreditimin e vëzhguesve të subjekteve politike përfundon më 5 shkurt, ndërsa i mediave më 9 shkurt.

Në këto zgjedhje do të marrin pjesë 21 subjekte politike, dy koalicione parazgjedhore dhe pesë iniciativa qytetare. KQZ-ja ka bërë me dije se numri i përgjithshëm i kandidatëve për këto zgjedhje është 1 079.

Lëvizja Vetëvendosje, Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës dhe Nisma Socialdemokrate nuk kanë bërë rirrenditjen e kandidatëve në listat zgjedhore, pas vendimit të 29 janarit të Gjykatës Supreme. Kështu tha Ylli Buleshkaj nga Zyra për Regjistrimin e Partive dhe Certifikim gjatë mbledhjes së Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Ai tregoi se për

këtë gjë partitë kanë pasur afat që t'i dërgojnë listat e rirrenditura deri të shtunën në orën 16:00.

Buleshkaj tha se vendet në listat e votimit të kandidatëve që nuk janë certifikuar do të hijezohen apo shenjzohen në mënyrë që qytetarët të mos ngatërrohen gjatë votimit dhe të zgjedhin ata numra. Më 29 janar, pasi partitë politike dërguan ankesa për moscertifikimin e disa kandidatëve të tyre për zgjedhjet e 14 shkurtit, Supremja mori vendim për t'i kthyer disa kandidatë në lista. Më 3 janar 2018 deputetët e atëhershëm të Lëvizjes Vetëvendosje, Albin Kurti, Albulena Haxhiu, Faton Topalli dhe Donika Kadaj-Bujupi, janë dënuar me kusht për hedhjen e

gazit lotsjellës në ambientet e Kuvendit të Kosovës. Në shtator të po atij viti, Gjykata e Apelit i ka vërtetuar dënimet e shqiptuara nga gjykata e shkallës së parë.

Nga Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës u është ndaluar të marrin pjesë në zgjedhje këtyre kandidatëve: Gani Dreshaj, Rrahim Ajeti dhe Shqipe Kastrati.

Nisma Socialdemokrate ka pasur 12 kandidatë për deputetë, të cilët kanë pasur probleme me ligjin dhe të cilët nuk janë certifikuar për zgjedhje: Vesel Krasniqi, Besnik Berisha, Filloreta Bytyçi, Valentina Alijaja, Xhafer Berisha, Aziz Thaçi, Musa Fetahaj, Hasime Daka, Fatmir Gërdellaj, Vehbi Avdullahaj, Endrit Shala dhe Adrian Nokaj.

Në vendimin e Gjykatës Supreme, po ashtu, partive politike iu pamundësua që t'i zëvendësojnë emrat e kandidatëve që kanë probleme me ligjin me kandidatë të rinj. Në mbledhjen e KQZ-së të mbajtur të shtunën, kryetarja e këtij institucioni, Valdete Daka, ka theksuar se me vendimin e Gjykatës Supreme, certifikimi i kandidatëve për deputetë tashmë është çështje e kryer. "Ne i kemi kandidatët e certifikuar të kthyer në lista dhe ne nuk na bie të votojmë se a do ta zbatojmë vendimin e Gjykatës Supreme. Ne vetëm obligohemi që ta zbatojmë. Nuk kemi çfarë të votojmë në atë drejtim sepse praktikisht, certifikimi është kryer nga një institucion tjetër dhe jo nga ne dhe kandidatët konsiderohen të certifikuar", ka thënë Daka. Por, sipas vendimit të Supremes, nga Lëvizja Vetëvendosje nuk janë certifikuar për zgjedhje: Albin Kurti, Albulena Haxhiu dhe Bajram Mavriqi. Kurti, ishte prijës i listës zgjedhore të Lëvizjes Vetëvendosje.

### Pse nuk u certifikuan kandidatët për deputetë?

Më 22 janar, në mbledhjen e KQZ-së, anëtarët e këtij institucioni votuan për t'i moscertifikuar listat zgjedhore të Lëvizjes Vetëvendosje, Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, Nismës Socialdemokrate dhe disa partive të komuniteteve joshumicë, pasi në to kishte kandidatë që kishin probleme me ligjin. Pas aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese, të publikuar dhjetorin e kaluar, lidhur me zgjedhjen e Qeverisë së Kosovës të drejtuar nga Avdullah Hoti, KQZ-ja ka ndërmarrë një proces të verifikimit të kandidatëve për deputetë, për të parë nëse ata nuk kanë probleme me ligjin.

Gjatë seancës së 22 janarit anëtarët e KQZ-së miratuan listat me kandidatë që nuk ishin ndesh me ligjin apo të atyre partive që kishin zëvendësuar emrat në listat e tyre pas verifikimit të kryer nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës. KGJK kishte thënë se 47 kandidatë ishin të papërshtatshëm për të garuar për deputetë. Aktgjykimi i Kushtetueses, por edhe neni 29 i Ligjit për zgjedhjet e përgjithshme, thotë se kandidat për deputet nuk mund të jetë një person i cili gjatë tri vjetëve të fundit ka qenë i dënuar me vendim të formës së prerë. Vendimin e 22 janarit të KQZ-së, LV-ja, AAK-ja dhe Nisma e apeluar në Panelin Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia dhe më pas në Gjykatën Supreme.

### Listat e reja, kryesisht me kandidatë të vjetër

Në listat e partive politike dominojnë figurat tradicionale të partive dhe nuk shihen shumë emra të rinj. Subjektet politike emrat kryesorë të tyre i kanë vendosur në dhjetëshen e parë të listës, ndërsa vend u kanë bërë edhe aderimeve të reja. Bartës të listave ato kanë vendosur pretendentët e tyre për kryeministër. Në lista subjektet politike kanë respektuar kuotat gjinore dhe kanë vendosur edhe kandidatë nga diaspora.

### Kosova edhe në këto zgjedhje po hyn pa reformë zgjedhore

Këto ditë Grupi për Studime Juridike dhe Politike (GLPS) ka mbajtur tryezën e diskutimit me temë "Reforma zgjedhore dhe zgjedhjet: a është reforma zgjedhore prioritet në programet e partive politike?". Përfaqësuesit e GLPS-së kanë theksuar se një reformë zgjedhore është e domosdoshme për t'i mënjeluar problemet e vazhdueshme në proceset zgjedhore.

GLPS-ja u ka bërë thirrje të gjitha partive politike në Kosovë, që të angazhohen për arritjen e një konsensusi të përgjithshëm, për ta çuar vendin drejt një reforme të mirëfilltë zgjedhore dhe, përfundimisht, të bëjnë përpjekje serioze për ngritjen e transparencës financiare të partive politike. Ndërkaq përfaqësues të partive politike kanë vënë theksin mbi politizimin e tejskajshëm me procesin e reformës zgjedhore duke potencuar se asnjëherë nuk ka ekzistuar një seriozitet i dëshiruar, por është përdorur më shumë për interesa politike, sidomos gjatë fushatave zgjedhore.

# Kosova regjistron edhe gjashtë viktima dhe 287 raste të reja me Covid

Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike i Kosovës (IKShPK) ka njoftuar të dielën se gjatë 24 orëve të fundit në Kosovë gjashtë pacientë kanë vdekur dhe janë regjistruar 287 raste të reja me Covid-19

**EPOKA  
ERE** **Faton DËRMAKU**

**PRISHTINË, 31 JANAR** - Gjatë 24 orëve të fundit në Institutin Kombëtar të Shëndetësisë Publike të Kosovës (IKShPK) dhe laboratorët privatë janë testuar gjithsej 2 438 mostra të marra nga Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës (ShSKUK) dhe gjurmimi i kontakteve të rasteve në terren, prej të cilave kanë rezultuar 287 raste pozitive me Covid-19. Brenda 24 orëve janë raportuar edhe gjashtë raste të të vdekurve si pasojë e këtij virusi. Rastet e të vdekurve janë nga: Deçan një rast (72 vjeç), Drenas një rast (69 vjeç), Gjakovë një rast (68 vjeç), Podujevë një rast (86 vjeç), Prizren një rast (60 vjeç), Suharekë një rast (59 vjeç). Numri total i rasteve pozitive është 60 218 raste nga 233 532 persona të dyshimtë me këtë

virus dhe 1 498 raste të vdekjes. Gjatë 24 orëve të fundit janë shëruar 229 pacientë derisa numri i përgjithshëm i të shëruarve deri më sot është gjithsej 52 437 raste, kurse numri i rasteve aktive është 6 283.

Rastet pozitive janë nga komunat: Prishtinë 90 raste, Pejë 20 raste, Podujevë 19 raste, Gjakovë 16 raste, Mitrovicë 16 raste, Suharekë 16 raste, Gjilan 14 raste, Ferizaj 13 raste, Fushë-Kosovë 12 raste, Lipjan 10 raste, Vushtrri 8 raste, Malishevë 7 raste, Istog 6 raste, Prizren 6 raste, Drenas 5 raste, Klinë 4 raste, Shtime 4 raste, Kamenicë 3 raste, Kaçanik 3 raste, Obiliq 3 raste, Viti 3 raste, Deçan 2 raste, Dragash 2 raste, Rahovec 2 raste, Skenderaj 2 raste dhe Junik 1 rast.


Duke pasur parasysh shfaqjen e rasteve të reja me variantin e ri të virusit SARS CoV-2 në Kosovë dhe vlerësimin e situatës aktuale me Covid-19, IKShPK-ja

ka përsëritur thirrjen për zbatimin e të gjitha masave të përgjithshme dhe specifike për mbrojtjen nga pandemia Covid-19. "Masat parandaluese janë të njëjta me aksent të veçantë se personat pozitivë duhet të qëndrojnë në shtëpi për ta parandaluar përhapjen në familje dhe në komunitet. Me zvogëlimin e kontakteve do ta bëjmë të mundur ndërprerjen e përhapjes së infeksionit.

Andaj rekomandojmë edhe një herë: 1. Të qëndrohet në shtëpi, dhe dalja të jetë vetëm për nevoja të domosdoshme; 2. Ndalimi rigoroz i takimeve me njerëz me të cilët nuk jetoni në bashkësi, pos për qëllime specifike; 3. Ndalimi rigoroz i tubimeve; 4. Respektimi rigoroz i masave kufizuese në aktivitetet publike; dhe 5. Kufizimi i punës për veprimtaritë joesenciale dhe vendngjarjet duke reduktuar edhe kohën e punës gjatë ditës", ka njoftuar IKShPK-ja.



# Për Mitrovicën...



Shkruan: Bedri ISLAMI

25 vjet më parë, kur ende nuk dihej e ardhmja e Kosovës, një njeri i mençur dhe që, më pas, dëshmoi se njeriu mund të vdesë ashtu si kishte folur, Fehmi Lladrovci, do ta bënte parashikimin e tij të saktë, thellësisht të qartë se, “e ardhmja e Kosovës do të përcaktohet në Mitrovicë”.

Ishte i bindur në mendimin e tij dhe kishte dhimbje të madhe në atë që thoshte, pasi si pakkush tjetër, në të gjithë atë enigmë të së ardhmes, ai e kishte të qartë se një popull që nuk është kujdesur kurrë për çatinë e vendit të tij, ai nuk do t'i kishte kurrë as themelet e qëndrueshme.

Në pamjen e jashtme ai kishte të përbashkëta me Isë Boletin: gjatësinë, hijeshinë, qëndrimin tipik malësor, sytë që i shkëndijonin, ecjen e avashtë, buzagazin për miqtë dhe fjalën e avashtë, por ngulmuese.

E donte Mitrovicën mbi gjithçka tjetër, jo thjesht për pasuritë e

saj të nëntokës, edhe ato i donte, por më shumë për atë çfarë ajo përfaqësonte, dhe e dinte krejt mirë se pushteti serb do të përpiqej të ngulte në veriun e shtetit të ri shqiptar, sepse ai ishte ithtar i madh i bashkimit të kombit, njëri nga thikat e tij. Ose vetë, ose përmes miqësive të hershme.

Kur lufta mbaroi, Fehmiu dhe Xheva nuk ishin më. Pushonin në njëri pjesë të luginës së Shkabajve, buzë së cilës rridhnin ujërat dhe hijeshojnë lisat.

Por çdo gjë që ai parashikoi për Mitrovicën, çdo gjë doli se kishte qenë e saktë.

Thika është ngulur në veriun e saj. Një fillesë ndarje është e pranishme, e cila mund të jetë edhe më e thellë, ngaqë miopia politike ka bërë që të rrjedhë shteti nëpër xhepat e pushtetarëve dhe mendimi politik të jetë diskurs i atyre që nuk e dinë as se si të ndërtohet gardhi i shtëpisë së tyre.

Mes të vërtetës dhe mashtrimit qëndron gjithnjë hija e së djeshmes!

Mes të vërtetëve dhe ikanakëve qëndron përherë çasti i provës. Mendja e një njeriu të veçantë dhe, të veçantë nga të gjitha pikëpamjet, ka saktësuar dy dekada e gjysmë përpara se ku do të qëndrojë dhembja e madhe e Kosovës.

Shumë nga shokët e tij janë

vrarë në luftë. Disa kanë mbetur veç për të koritur të djeshmen e tyre! Të tjerë nuk kanë të ardhme!

Asnjëri, i vetëm, nuk mund ta krijojë të tërën!

Në boshllëk tingujt ecin më shpejt, duket se kumbojnë më fort, por humbin rrugës dhe

shkërmoqen nga e zbrazëta rreth tyre!

Ai lider në Kosovë apo kudo qoftë, që do ta zgjidhë çështjen e Mitrovicës, a me hatër a pa hatër, ai do të jetë burrshteti i shqiptarëve.

Ai do të jetë Prijësi!

Të tjerë janë liderë që shkojnë e

vijnë në një skenë të madhe, ku perdja ka rënë, ende pa u mbyllur akti i së ardhmes!

Fehmiu ishte Prijës!

Dhe ishte ndër ata burra që i kishte hije të jetë Prijës!

Dhe si i tillë parashikoi 25 vjet më parë se ku do të ishte e ardhmja!



## Mbi 904 persona morën statusin e viktimës së dhunës seksuale

PRISHTINË, 31 JANAR - Komisioni qeveritar për njohjen dhe verifikimin e statusit të personave të dhunuar gjatë luftës së fundit në Kosovë deri tash ka pranuar mbi 1 389 aplikacione për pension, ku 50 për qind e lëndëve janë trajtuar mbi tri herë. Kryetarja e këtij komisioni, Minire Begaj-Balaj, ka thënë se prej aplikacioneve që kanë pranuar, 31 janë burra të cilët kanë përfituar këtë pension nga shteti, kurse të tjerat janë gra. Ndërsa

ky komision ka refuzuar 240 lëndë të pranuar. “Prej vitit 2018 katër organizatat joqeveritare që janë të licencuara nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale nga shtatë regjione, kanë arritur t'i pranojnë 1 389 aplikacione. Prej këtyre komisioni ka arritur t'i shqyrtojë 1 203 aplikacione, ndërsa ia kemi njohur statusin e viktimës së dhunës seksuale 904 personave”, ka bërë me dije Begaj-Balaj.



## Në hyrjen e banesës së babait të Fatmir Limajt vendoset pllakë përkujtimore

PRISHTINË, 31 JANAR (ER) - Në rrugën “Rexhep Luci” në Prishtinë të dielën është bërë shpалosja e pllakës përkujtimore të njëri prej bazave të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Më saktësisht, kjo është bërë në banesën e babait të kreut të Nismës Socialdemokrate, Fatmir Limaj. Djali i Kadri Limaj, Demir Limaj, tha se në këtë

banesë kanë qëndruar figurat e UÇK-së dhe shumë plane operative janë bërë në këtë banesë. Ndërsa Fatmir Sopaj, kryetari i OVL-së - Dega në Prishtinë, tha se kjo është baza ku janë marrë vendime të rëndësishme. “Unë falënderoj familjen Limaj që ka pasur guxim që banesën ta lëshojë në shërbim të ushtarëve të UÇK-së”, tha Sopaj.

# Në 24-vjetorin e rënies, përkujtohen Zahiri, Hakifi dhe Edmondi



Njëzet e katër vjet më parë në Pestovë të Vushtrrisë u vranë nga policia serbe Zahir Pajaziti, Hakif Zejnullahu dhe Edmond Hoxha. Me rastin e përvjetorit të tyre, përfaqësues të institucioneve të Kosovës dhe liderë të partive kanë bërë homazhe te shtatorët e këtyre tre heronjve, duke theksuar se Zahiri, Edmondi dhe Hakifi ishin celulat e para të organizimit dhe fuqizimit të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK), të cilët e lëshuan zërin e tyre në të gjitha trevat për t'u bashkuar për lirinë e Kosovës

EPOKA  
ERE

Qendresa RAMA

**PRISHTINË, 31 JANAR** - Kryeministri në detyrë i Kosovës, Avdullah Hoti, ka bërë homazhe dhe ka vendosur kurora me lule të dielën te shtatorja e heroit Zahir Pajaziti në Prishtinë, në 24-vjetorin e rënies së tij. "Sot nderojmë kontributin e Zahir Pajazitit dhe të gjithë bashkëluftëtarëve të tij, të gjithë atyre që kanë rënë për lirinë dhe pavarësinë të cilën e gëzojmë sot. Është bërë ritual që ne çdo vit t'i bëjmë nderimet për ta dhe përmes tyre ta shprehim respektin për të gjithë bashkëluftëtarët e tyre në mbarë Kosovën", ka thënë kryeministri Hoti.

Pas homazheve te shtatorja e Zahir Pajazitit në Prishtinë, Hoti bashkë me ministrin e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Vlora Dumoshi, ministrin e Punëve të Brendshme, Agim Veliu dhe ministrin e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Besian Mustafa, kanë vizituar edhe Kompleksin Memorial



"Zahir Pajaziti" në Orllan të Podujevës.

Edhe kryetari në detyrë i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), njëherësh kandidat për kryeministër, Enver Hoxhaj, së bashku me anëtarë të tjerë të PDK-së, kanë bërë homazhe para shtatores së heroit, Zahir Pajaziti, në 24-vjetorin e rënies

së tij. Hoxhaj ka theksuar se sot në këtë përvjetor janë pa praninë e të parit të PDK-së, Kadri Veseli, të presidentit Hashim Thaçi dhe Jakup Krasniqit, të cilët po përballen me Gjykatën Speciale. "Kjo ditë është e veçantë për Kosovën, kur në rrugëtimin tonë për liri po e

paguajmë përsëri një çmim të dytë. Dhe këtë çmim të dytë po e paguajmë para një gjykate. E para saj kauza jonë për liri, ne jemi të sigurt që shokët tanë do të dalin fitimtarë dhe faqebardhë. Ndërsa ne si Parti Demokratike e Kosovës do t'i ndjekim idealet e tyre, do t'i ndjekim qëllimet e tyre dhe do ta përmbylim shtetndërtimin e Kosovës duke e anëtarësuar Kosovën në OKB, në Bashkim Evropian dhe në NATO", ka thënë Hoxhaj.

Më tutje, Hoxhaj me bashkëpunëtorë ka bërë homazhe në Kompleksin Memorial në Lladoc. Ai gjatë homazheve është takuar me babanë e heroit, Hakif Zejnullahu. Në këtë vend është edhe shtëpia e heroit të kombit Hakif Zejnullahu, e cila ka shërbyer si vend nga ku niseshin për aksione pjesëtarët e parë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Homazhe te shtatorja e Zahir Pajazitit në Prishtinë kanë bërë edhe ushtruesja e detyrës e presidentit të Kosovës, Vjosa Osmani dhe lideri i Lëvizjes Vetëvendosje, Albin Kurti. "24

vjet më parë në Pestovë të Vushtrrisë u vranë nga policia serbe Zahir Pajaziti, Hakif Zejnullahu dhe Edmond Hoxha. Ata ishin kushtrimi çlirimtar i luftëtarëve të paepur. Serbia vendoste prita vrasare, mirëpo UÇK-ja bëhej e pandalshme. E në të njëjtën ditë, më 31 janar, por edhe shtatë vjet më herët sesa rënia heroike e Zahirit, Hakifit dhe Edmondit, pra në vitin 1990, në Gjakovë, sërish policia serbe vrau, në demonstratën për liri dhe republikë, Fatmir Kërleshin dhe Xhevat Hoxhën. Lagjja 'Gecë', ku ranë këta dy dëshmorë, sot quhet Parku i Lirisë. Në historinë tonë pothuajse nuk ka ditë dëshmori që nuk është edhe ditë e një dëshmori tjetër në një kohë tjetër. Jo vetëm shumë i lartë, por edhe gjatë i shtrirë në kohë është çmimi i lirisë sonë", ka thënë Kurti.

Po ashtu, edhe kryetari i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Ramush Haradinaj, ka përkujtuar Zahir Pajazitit, Edmond Hoxhën dhe Hakif Zejnullahun, duke theksuar se njëzet e katër vjet më parë ata u shndërruan në pikëmbështetje të vizionit tonë për Kosovën. "Shembuj të atdhedashurisë dhe vetëmohimit, në kërkim të lirisë dhe të drejtës së shqiptarëve. Zahir Pajaziti, Edmond Hoxha dhe Hakif Zejnullahu, njëzet e katër vjet më parë u shndërruan në pikëmbështetje të vizionit tonë për Kosovën. Lavdi e përjetshme!", ka shkruar Haradinaj në llogarinë e vet në "Facebook".

Kryetari i Nismës Socialdemokrate, Fatmir Limaj, së bashku me anëtarë të tjerë të kësaj partie, kanë bërë homazhe para shtatores së heroit Zahir Pajaziti, në 24-vjetorin e rënies së tij. "Sot 24 vjet më parë Ushtria Çlirimtare e Kosovës mori një goditje të rëndë e të madhe, vrasjen e drejtuesve të saj dhe arrestimin e dhjetëra pjesëtarëve të UÇK-së. Komandant Zahir Pajaziti, Edmond Hoxha dhe Hakif Zejnullahu ishin promotorë, ishin celulat e para të organizimit e fuqizimit të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, të cilët e lëshuan zërin e tyre në të gjitha trevat për t'u bashkuar për lirinë e Kosovës. Në atë kohë, e humbëm Zahirin, Edmondin e Hakifin dhe na arrestuan edhe shumë të tjerë, por zëri, fryma dhe angazhimi çlirimtar nuk u ndalën për asnjë çast deri në çlirimin e Kosovës. Lavdi jetës dhe veprës së komandant Zahir Pajazitit dhe gjithë dëshmorëve të kombit!", ka thënë Limaj.



# Ndërtimi i 'Autostradës së Paqes', këtë vit



Hazir Reka (Reuters)

**PRISHTINË, 31 JANAR** - Autostrada Prishtinë - Merdar, e njohur edhe si "Autostrada e Paqes", do të fillojë të ndërtohet në mesin e këtij viti, thotë për "Radion Evropa e Lirë", ministri në detyrë i Infrastrukturës në Kosovë, Arban Abrashi. Kjo autostradë është një nga projektet e përfshira në marrëveshjen për normalizim ekonomik të nënshkruar më 4 shtator në Uashington ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. "Në kemi prezantuar planin e fizibilitetit të pala amerikane dhe pranë Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZh). Me ndihmën e palës amerikane, kemi aplikuar për financim. Përkundër që kemi proces zgjedhor, financimi do të aprovohet. Synojmë që në pranverë - sepse duhet të ketë edhe marrëveshje të re ndërkombëtare financiare që duhet të kalojë në Kuvend - të mbyllim këtë marrëveshje, në mënyrë që të fillojnë procedurat për ndërtimin e autostradës diku në mes të këtij viti", shton ai. Kjo autostradë në territorin e

Kosovës është vazhdimësi e autostradës "Ibrahim Rugova", që ka përfunduar deri në Besi, fshat ky që gjendet rreth magjistrales Prishtinë - Podujevë.

Janë edhe rreth 27 kilometra të tjera që do të ndërtohen deri në Merdar, ndërkaq kostoja e ndërtimit, sipas ministrit në detyrë, Abrashi, përafërsisht është mbi 200 milionë euro.

## Fizibilitet për hekurudhat Beograd - Prishtinë

Sa i përket projektit tjetër që del nga marrëveshja e Uashingtonit, ai i ndërtimit të infrastrukturës hekurudhore Beograd - Prishtinë, me një port në det të thellë në Adriatik, Abrashi thotë se pasi të hartohet projekti, do të aplikohet për financim në mekanizmat financiarë ndërkombëtarë. "Te hekurudha kemi kërkuar nga Korporata Financiare për Zhvillim e ShBA-së (DFC) të fillojë zyrtarisht t'i identifikojë ekipet që do të bëjnë studimin e fizibilitetit për

hekurudhën nga Merdari deri në Durrës. Për ta ndihmuar këtë proces, ne kemi nënshkruar marrëveshje me Qeverinë e Shqipërisë, ku të dyja palët zotohemi të punojmë bashkë për hartimin e fizibilitetit të këtij projekti", thotë ai.

Ndërtimi i një linje hekurudhore nga Prishtina deri në portin e Adriatikut, nga ministri në detyrë, Abrashi, vlerësohet projekt i rëndësishëm, pasi që rrit pozitën gjeostrategjike dhe Kosova bëhet vend transit i mallrave për Ballkan dhe Evropën Qendrore.

Për ta lehtësuar zbatimin e këtyre marrëveshjeve, ministri në detyrë, Abrashi, bëri me dije se Korporata Financiare për Zhvillim e ShBA-së, së shpejti do ta ketë edhe zyrtarin e tij në Kosovë. Sipas tij, përmes kësaj zyre do t'u jepet qasje më e madhe bizneseve të Kosovës për t'i prezantuar projektet dhe planet e tyre. "Bizneset do të jenë në gjendje të ngrehin kapitalin e tyre në ShBA dhe kjo ngritje e kapitalit do të garantohet nga Qeveria e Kosovës dhe DFC-ja",

thotë Abrashi.

DFC-ja është bankë e zhvillimit të Amerikës, e cila bashkëpunon me sektorin privat, duke financuar zgjidhjet e sfidave më kritike me të cilat përballet bota në zhvillim. DFC-ja investon në sektorë, duke përfshirë energjinë, kujdesin shëndetësor, infrastrukturën kritike dhe teknologjinë. DFC, po ashtu, siguron financim për bizneset e vogla dhe gratë sipërmarrëse, me qëllim krijimin e vendeve të punës në tregjet në zhvillim.

## Vonesa për realizimin e projekteve

Oda Ekonomike e Kosovës (OEK) do të ofrojë mbështetje për zbatimin e projekteve që kanë të bëjnë me sektorin privat. Në fillim të këtij viti OEK-u dhe DFC-ja janë marrë vesh t'i identifikojnë projektet e para që mund të financohen nga kjo korporatë zhvillimore.

Kryetari i OEK-ut, Berat Rukiqi, thotë për Radion Evropa e Lirë se

janë në diskutim me stafin e Korporatës Financiare për Zhvillim e ShBA-së për të parë se cilat projekte të sektorit privat mund të financohen. "Ka disa fusha, ka interes te fusha e energjisë, turizmi, në përgjithësi ka interes te projektet që mund të gjenerojnë eksport dhe vende pune", thotë Rukiqi.

Por, realizmi i projekteve, shton Rukiqi, do të vonohet për shkak të zgjedhjeve të parakohshme parlamentare që do të mbahen më 14 shkurt si dhe nga jostabiliteti politik në Kosovë. Ndryshe, me realizimin e këtyre projekteve, siç janë prononcuar liderët politikë në Kosovë dhe në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, do të hapen shumë vende pune, duke mundësuar uljen e nivelit të lartë të papunësisë. Sipas të dhënave të Agjencisë së Statistikave të Kosovës, çdo vit në tregun e punës hyjnë deri në 25 mijë persona, të gjithë të gjeneratës 18 vjeç e më lart. Sipas të dhënave të po kësaj agjencie, shkalla e papunësisë është rreth 30 për qind.



# Kryeministri në detyrë thotë se ekonomia po i kthehet normalitetit

PRISHTINË, 31 JANAR (ER) - Kryeministri në detyrë, Avdullah Hoti, ka thënë se ekonomia e vendit po i kthehet normalitetit dhe qarkullimi i bizneseve është rritur dukshëm. Hoti përmes një postimi në llogarinë e vet në "Facebook" ka theksuar se të hyrat nga Dogana në janar 2021 janë 11 përqind më të larta se të janarit 2020, sipas tij, kur nuk ka

pasur pandemi dhe kufizime. "Lajm shumë i mirë: Ekonomia po i kthehet normalitetit. Qarkullimi i bizneseve është rritur dukshëm. Të hyrat nga Dogana në janar 2021 janë 11 përqind më të larta se të janarit 2020, kur nuk ka pasur pandemi dhe kufizime. Ndërkaq, të hyrat nga ATK-ja në janar 2021 janë të ngjashme me janarin e vitit

2020", ka shkruar Hoti. Ai ka thënë se kthimi në normalitet është rezultat i pakos së rimëkëmbjes për vitin 2020 prej 365 milionë eurosh, Ligjit për Rimëkëmbje që ka mobilizuar menjëherë në dhjetor mbi 200 milionë euro për qytetarë, pakos së rimëkëmbjes për vitin 2021 në shumë prej 222 milionë eurosh që ka nisur të

zbatohet, si dhe efektit të shpenzimeve të diasporës në dhjetor të vitit të kaluar. "Me ardhjen e vaksinës do ta mundim plotësisht këtë pandemi e do t'i kthehemi jetës dhe punës normalisht. Mirënjohës ndaj atyre që kanë qëndruar në ballë të kësaj pandemie për një vit të tërë. Jam mirënjohës ndaj ekipit të mrekullueshëm brenda

kabinetit tim si dhe ndaj gjithë kabinetit qeveritar. Sigurisht, kërkoj mirëkuptim për presionin e bërë ndaj tyre që t'i zbatojmë sa më shpejt masat e rimëkëmbjes. Kur sheh këto rezultate, e kupton se ia ka vlejtur çdo minutë e punës dhe angazhimit, si dhe ballafaqimit publik për t'i mbrojtur politikat tona ekonomike", ka shkruar Hoti.



## Trusti kushtëzon shtetasit e huaj për tërheqjen e 10-përqindëshit të kursimeve

PRISHTINË, 31 JANAR - Mijëra kontributdhënës në Trust me shtetësi jokosovare e që vijnë nga Shqipëria, Maqedonia e Veriut apo Lugina e Preshevës mbeten të kushtëzuar për tërheqjen e 10-përqindëshit të mjeteve të kursyera pas aprovimit të Ligjit për Rimëkëmbjen Ekonomike. Posedimi i numrit personal të Kosovës, qoftë i përkohshëm ose i përhershëm, mbetet kusht për shtetasit e huaj të aplikojnë për tërheqjen e 10-përqindëshit të mjeteve në Trust.

Zëdhënësi i Trustit, Jeton Demi, ka thënë se numri



personal i Kosovës duhet të përputhet me numrin e

llogarisë bankare. Për këtë çështje, sipas tij, janë refuzuar

mijëra shtetas të huaj që punojnë në Kosovë për tërheqjen e mjeteve të tyre nga Trusti. "Nuk kam statistika të sakta. Mund të jenë me qindra ose mijëra (refuzime të aplikimeve nga shtetas të huaj). Numri personal i Kosovës është kusht dhe në momentin që ky numër përputhet me numrin personal në bankë që është si informacion i konfirmimit të identitetit të tyre, ata bëjnë aplikimin pa problem. Kjo ka ndodhur që në fillim dhe shumica e tyre e kanë pasur në bankë një numër personal tjetër nga ai që e kanë pasur në llogarinë pensionale në Trust.

Pra, për këtë ka qenë i pamundur aplikimi. Ka të punësuar në sektorë të ndryshëm. Kemi të punësuar edhe nga Shqipëria, nga Maqedonia dhe nga Lugina e Preshevës me rrethinë, të cilët i kanë pasur këto vështirësi administrative teknike", ka thënë Demi.

Ai ka pranuar se për këto kushtëzime kanë pranuar një numër të madh të ankesave me telefon dhe në mënyrë elektronike. Në anën tjetër, Demi ka thënë se nuk e dinë sa mund të jetë numri i saktë i kontributdhënësve në Trust që janë shtetas të huaj.

## Përkujtohet masakra e vitit 1990 në Malishevë, ku u vranë Hisni Mazreku dhe Ali Kryeziu

**MALISHEVË, 30 JANAR (ER)** - Me aktivitete të shkurtuara për shkak të situatës së pandemisë, në Malishevë, me rastin e 31-vjetorit të rënies, janë përkujtuar dëshmorët Ali Kryeziu dhe Hisni Mazreku, e njohur në publik si "Masakra e Malishevës", ngjarje e cila ka shënuar kthesë në historinë tonë, pasi për herë të parë filluan reagimet institucionale kundër regjimit të kohës. Në nderim të kësaj ngjarje dhe të rënies së dëshmorëve Mazreku e Kryeziu, qeveria komunale e Malishevës, së bashku me familjarë dhe të

afërm të tjerë të tyre, kanë bërë homazhe në vendin e ngjarjes në qendër të qytetit të Malishevës, e më pas janë bërë homazhe edhe në varrezat në Malishevë dhe Bubavec. "Dëshmorët dhe të gjithë të rënë ne do t'i kujtojmë përgjithmonë, pasi me këtë e kujtojmë dhe të kaluarën tonë dhe historinë tonë", ka thënë drejtori i Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport, Rexhep Mazreku, i cili ka kërkuar nga organet përgjegjëse, se këto ngjarje historike, përfshirë edhe luftën e lavdishme të UÇK-së, sa më shpejt t'i fusin

në librat e historisë dhe nxënësit të mësojnë për historinë e popullit tonë. Kjo ngjarje, krahas vrasjeve, plagosjeve dhe maltretimeve nga aparati shtetëror i regjimit të atëhershëm, shënon edhe reagimin e parë institucional në Kosovë, ku Komuna e Malishevës, përmes organeve të vetat komunale, por edhe përmes përfaqësuesve të saj në Kuvendin e Kosovës, kanë reaguar ndaj ngjarjeve dhe vrasjeve sistematike të shqiptarëve të pafajshëm, duke e kundërshtuar në mënyrë të hapur regjimin e atëhershëm.



## Vërshimet e fundit në Drenas mbulojnë disa ura dhe toka bujqësore



**DRENAS, 31 JANAR (ER)** - Reshjet e vazhdueshme të shiut gjatë të shtunës kanë shkaktuar ngritje të nivelit të ujit në disa zona, ku lumi "Drenica" ka dalë nga shtrati dhe për pasojë janë mbuluar disa ura në fshatin

Dobroshec e Çikatovë e Vjetër të Komunës së Drenasit, po ashtu janë mbuluar edhe disa rrugë. "Ekipet emergjente janë në terren dhe po monitorojnë situatën. Nuk ka vërshime në shtëpi banimi, vetëm në

disa segmente rrugore, ura e vërshime në toka bujqësore. Ftojme qytetarët të kenë kujdes të shtuar dhe t'u shmangen vendeve ku uji ka vështirësuar qarkullimin", ka njoftuar Komuna e Drenasit.

## Në dy javët e para asnjë rast i infeksionit me Covid në shkollat e Gjilanit

**Gjilan, 31 janar (ER)** - Që prej fillimit të gjysmëvjetorit të dytë asnjë rast i infeksionit me Covid-19 nuk është regjistruar në shkollat e Gjilanit, përfshirë institucionet parashkollore, shkollat fillore e të mesme.

Drejtori i Arsimit, Nazim Gagica, ka bërë thirrje për kujdes të vazhdueshëm në mënyrë që shkollat t'i mbahen të hapura dhe të parandalohet mësimi online. "I lumtur që në shkollat e Gjilanit gjendja është

stabile me Covid-19. Nuk kemi të shënuar raste që nga fillimi i periudhës së dytë mësimore, edhe pse shkollat e mesme të ulët, procesin mësimor e zhvillojnë me orar të rregullt dhe të plotë", ka thënë Gagica.



## Komuna e Podujevës i jep në shfrytëzim një automjet Qendrës së Shëndetit Mendor



**PODUJEVË, 31 JANAR (ER)** - Ashtu siç kishte premtuar kryetari i Komunës së Podujevës, Shpejtim Bulliqi, gjatë takimit të javës që shkoi me drejtorin regional të Qendrës së

Shëndetit Mendor në Prishtinë, Sami Rexhepi, Komuna e Podujevës i ka dhënë Qendrës së Shëndetit Mendor në Podujevë në shfrytëzim një automjet për

intervenime në terren, që është në pronësi të komunës. Drejtori i Administratës në Komunën e Podujevës, Bahri Selimi, ka pritur në zyrë përfaqësuesit e Qendrës së

Shëndetit Mendor në Podujevë, me ç'rast ka nënshkruar dokumentin për dhënien në shfrytëzim të automjetit të komunës për këtë institucion.

## Gjakova përkujton 30 dëshmorët

**GJAKOVË, 31 JANAR (ER)** - Janë përkujtuar 30 dëshmorët e rënë më 27, 28 dhe 29 janar të vitit 1999 në fshatrat Bishtazhin, Goden dhe Rogovë të Hasit. Ceremonia përkujtimore ka nisur me homazhe dhe nderime pranë lapidarit të dëshmorit Gaspër Karaqi duke vijuar me nderime te memoriali i të rënëve si dhe homazhe në varrezat e dëshmorëve në Rogovë të Hasit. "Është obligim yni ta mbajmë gjallë

kujtimin dhe figurën e tyre si pjesë e lavdishme e historisë sonë", tha në fjalën e tij kryetari i komunës, Ardian Gjini. Rënia e këtyre dëshmorëve konsiderohet humbja më e madhe për Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës, pasi në këtë grup ishin disa nga udhëheqësit më të mirë të luftës, në mesin e tyre edhe komandantët e shquar në rrafshin e Dukagjinit, Agron Rama dhe Agim Zeneli.



Aziz Kelmendi dhe enigma e vrasjeve pa luftë në kohë robërie (15)

# Një përshkrim i shkurtër për Kazermën Ushtarake 'Branko Krsmanoviq' në Paraqin



Lulzim SAHTI

Paraqini është qytet në Serbinë qendrore dhe shtrihet në luginën e lumit Morava, në veri të Krushevcit dhe në juglindje të Kragujevcit. Nëpër këtë qytet kalon autostrada (E75) Beograd - Nish. Pranë saj, në të djathtë, gjendet Kazerma Ushtarake "Branko Krsmanoviq". Deri pak ditë pa ndodhur ngjarja e Paraqinit, rekrutët tanë e përshkruajnë vendin ku shërbyen në këtë mënyrë. Garnizoni në fjalë e kishte portën hyrëse të ngjashme si shumë porta kazermash të tjera në ish-Jugosllavi. Me ngjyrë "es-em-be", e metaltë, në të cilën domosdoshmërisht bëhej kujdestaria me ndërrime nga ushtarët dhe kishte zyrën e regjistrimit për hyrje-dalje. Pasi që ato ditë objekti i muratuar për roje po rregullohej dhe ngjyrosej, roja ishte zhvendosur në dy çadra, ku në njërin pak më të vogël ishte vendosur komandanti i rojës, kurse në tendën tjetër ushtarët që ishin në përbërje të rojës. Rreth tridhjetë hapa nga hyrja në kazermë ndodhej ndërtesa ushtarake e banimit, kati përdhes dhe kati i parë. Njësitë ishin të vogla sa i përket formacionit ndërsa, për arsye të tjera, e gjithë ushtria ato ditë mund të akomodohej në tri dhoma të fjetjes, numër 40, 41 dhe 42. Përballë tyre, në të majtë, ishte hyrja në të parën, në të djathtë në dhomën e dytë dhe tretë.


Midis dy hyrjeve ishte një dollap me renditje për peri të armëve të këmbësorisë dhe gjësende të tjera ushtarake. Në të djathtë të derës së dhomës 42, ishte dollapi metalik (ku ishin 10 fishekë për nevoja emergjente), për të cilin e dinin pothuajse të gjithë ushtarët se çka ka brenda kjo arkë. Mbi të ishte gazeta e murit me një nga fotografitë e njohura të luftës së Titos, në mes. Në skajin tjetër të simetrisë boshtore ishte fotografia me një tufë fytyrash të rinjsh të qeshur...

Në dhomën numër 40 flinin ushtarët që i përkisnin postës ushtarake 7518, domethënë njësisë së ndarë depoistë, e cila njësi ishte e stacionuar në Nish. Ushtarët e kësaj njësie ushtarake me ndërrime bënë roje në vendin "Karadjordjevo Brdo", rreth 3 kilometra larg kazermës. Atje një javë bënë roje duke u

kujdesur për sigurinë e 28 depove të mëdha të armatimit dhe municionit të llojllojshëm. Mandej një javë tjetër këta ushtarë e kishin të lirë, të cilët gjatë kësaj jave janë marrë kryesisht me ngarkim-shkarkim të municionit dhe mirëmbajtje të objekteve ushtarake. Ndërsa në dhomën numër 41 dhe 42 ishin pjesëtarët e postës ushtarake 5313 të Paraqinit, të cilët kryesisht kanë qenë logjistikë, që janë marrë me punë të kuzhinës, roje brenda kazermës si dhe kanë kryer punë të rëndomta ushtarake. Përndryshe, në kohën kur ka ndodhur rasti i Paraqinit që lëkundit themelet e ish-Jugosllavisë, Kazerma Ushtarake e Paraqinit ishte nën komandën ushtarake të Kazermës së Zajeçarit (Serbi), ku komandant i këtij garnizoni ishte kolonel Ramadan Qehaja. Kazerma e Paraqinit pas Luftës së Dytë Botërore ishte pagëzuar me emrin e Branko Krsmanoviqit (1915-1941), i cili ishte pjesëmarrës në Luftën Civile Spanjolle dhe Luftën e Dytë Botërore.

## Kush ishin mbrojtësit e të akuzuarve në Procesin e Paraqinit?

Sipas ligjit, të akuzuarit kishin të drejtë të kenë avokatë mbrojtës zyrtar dhe të angazhuar nga familjet e tyre. Me këtë rast, Abdylxhemil Alimani kishte avokat privatë Sava Kocarevin nga Shkupi, ndërsa mbrojtësi i tij sipas detyrës zyrtare ishte eprori Argir Grebernakov. Ndërsa,



Aziz Kelmendi

Shefqet Paçarizi, sipas detyrës zyrtare kishte mbrojtës eprorin Svetislav Trajkoviq, kurse mbrojtësi i Enver Behlulit, ishte eprori Milisav Gjorgjeviq. Ushitari, Islam Mahmuti, mbrojtës sipas detyrës zyrtare kishte eprorin Radisav Vuçetiç. Mbrojtësi i Rizah Gjaklit ishte avokati privatë Isa B. Mustafa nga Gjilani, ndërkaq mbrojtësi i tij zyrtar ishte eprori Spase Stojanovski. Rekruti Afrim Mehmeti për mbrojtës privatë kishte angazhuar avokatin e njohur kosovar, Bajram Kelmendi nga Prishtina dhe mbrojtësi i tij sipas detyrës zyrtare, ishte eprori Novica Pejçiq. Ndërkaq, avokatin privatë nga Prishtina, Metush Sadikun kishte angazhuar Pajazit Aliu, ndërsa dhjetari Rizo Alibashiq, mbrojtës sipas detyrës zyrtare kishte, eprorin

Nedelko Saviq. Të gjithë avokatët privatë veç e veç u angazhuan në mbrojtjen e klientëve të tyre dhe kërkuan që në mungesë të fakteve ata të lirohen nga aktakuza, ndërsa avokatët ushtarak të caktuar sipas detyrës zyrtare më shumë ishin në shërbim të prokurorisë sesa të të akuzuarve.

Gjatë hetuesisë, në muajin dhjetor të vitit 1987, avokati Bajram Kelmendi së bashku me avokatët e tjerë kishte vizituar të akuzuarit në Burgun Ushtarak të Nishit dhe gjatë një interviste dhënë revistës "Zëri" më 28. 9. 1991 kishte përshkruar në këtë mënyrë gjendjen e të pandehurve shqiptarë:

"Kur shkua ditën e parë në Nish për t'i vizituar të akuzuarit nuk na lejuan duke na thënë se ata, të burgosurit, janë në pushim. Të nesërmen na lejuan, por me ne ishte një oficer me gradën major.

Hyra në burg dhe sollën klientin tim, Afrim Mehmeti. Ai ishte kërrusur, dhe rrinte me duart prapa shpine. E përshëndeta dhe i thashë se mua më ka caktuar familja e tij për ta mbrojtur. Oficeri më tha serbisht: "Jo nuk mundesh kështu..." Shihej ashiqare se, përmes presionit, donin të na bënin ne avokatëve privatë të heqim dorë nga mbrojtja e të pandehurve.

Dikur arrita t'i them Afrimit se "nëna jote më ka angazhuar të të mbroj". Mirëpo, oficeri i tha, po ashtu serbisht: "Dëgjo Afrim, ky është avokati Bajram Kelmendi. A e do ti mbrojtësin që ta kemi caktuar ne, apo këtë?"

Pasi mendoj pak, pranoi të jam

mbrojtësi i tij. Pastaj kërkova nga oficeri që të më linte vetëm me Afrimin.

Kërkova prej Afrimit të ma thoshte të vërtetën, por ai më tha: "Shok avokat nuk mund ta tregoj të vërtetën, sepse nëse ta tregoj të vërtetën, të marr në qafë, se do të të burgosin edhe ty..."


Afrimi ishte i lodhur e i tjetërsuar, ia kishin shkëlur personalitetin. Fillova ta pyes butësisht dhe më në fund më tha se asnjëri prej tyre nuk e kishte kryer veprën penale për të cilën akuzoheshin dhe se të gjitha ato që i kishin pranuar në hetuesi ishin të pavërteta.

Në pyetjen time se si e pranuan një gjë të tillë m'u përgjigj se s'kanë pasur rrugëdalje tjetër, se u kanë thënë se i vetmi kusht për t'i shpëtuar dënimit me vdekje është që ta pranonin bashkëpjesëmarrjen në vrasje. Të gjitha ato që thuhet në aktakuzë janë trillime: Pohimet për ushtrimin me pushkë të Azizit, marrëveshjen në fushën e sportit, për ikjen nga dhomat e fjetjes etj. etj.

Por, pasi që i kanë marrë në pyetje me dhjetëra e dhjetëra herë, ditën dhe natën, janë detyruar të pranojnë se e kanë bërë veprën e pabërë.

Megjithatë, deklaratat e tyre nuk janë përputhur. Edhe pas ballafaqimit të të akuzuarve nuk është arritur te harmonizimi i deklaratave. Pastaj, ata janë nxjerrë në "vendin e ngjarjes" dhe është bërë "rikonstruktimi" (dhe incizimi me kamerë) i ngjarjes. Prapë nuk janë përputhur përshkrimet dhe deklaratat..." (Vijon)





**EURO GLASS**  
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON  
Enveri  
Adr: Fushë Kosovë  
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336  
E-mail: euro.glass@live.com



**QENDRA SPORTIVE  
'BUJOËSIA'**  
TEL: 045/82 82 82

# Ponte Prizreni triumfon ndaj Rahovecin, Trepça mposhti Vëllaznimit

**PRIZREN, 28 JANAR** - KB Ponte Prizreni ka fituar ndaj Rahovecin në udhëtim 87:98 (20:33, 21:15, 20:24, 26:26), në kuadër të javës së 18-të në Superligën së Kosovës në basketboll. Mysafirët e nisën më mirë ndeshjen, duke pasur epërsi deri në 15 pikë në çerekun e parë, kurse rezultati i kësaj pjese ishte 20:33. Vendasit kundërpërgjigjen në periudhën e dytë, duke e fituar 21:15, kurse skuadrat shkuan në pushim me rezultat 41:48. Prizrenasit kishin epërsi deri në 14 pikë në periodën e tretë, 50:64, ndërsa rezultati pas 30 minutash në semafor ishte 61:72. 10 minutat e fundit ishin kryesisht të barabartë, derisa Ponte Prizreni triumfon në fund 87:98. Te Rahoveci u dallua Isaiha Traylor me 21 pikë e shtatë asistime, kurse te Ponte Prizreni u dalluan Arti Hajdari me 22 pikë e shtatë asistime dhe Xavier Cannefax me 22 pikë, 7 kërcime dhe 8 asistime. Rahoveci ka 12 fitore dhe gjashtë humbje, kurse Ponte Prizreni 13 fitore dhe pesë humbje. Trepça ka shënuar fitore të rëndësishme ndaj Vëllaznimit në udhëtim me shifrat 82:83 (13:10, 23:28, 22:19, 24:26), në kuadër të javës së 18-



të në Superligën e Kosovës në basketboll. Loja e baraspeshuar u zhvillua në çerekun e parë, me vendasit që fituan këtë pjesë për vetëm tri pikë, 13:10. Kuqezinjtë vazhduan me lojë të mirë edhe në periudhën e dytë, duke pasur epërsi në dhjetë pikë, 29:19, por më pas mysafirët hyjnë në një seri të suksesshme dhe përfundojnë pjesën e parë me dy pikë epërsi, 36:38. Perioda e tretë ishte mjaft e barabartë, ku asnjëra skuadër nuk arrinte të shkëputej në epërsi, kurse rezultati në semafor pas 30 minutash ishte 58:57. 10 minutat e fundit ishin mjaft interesant. Pas një fillimi të barabartë, mysafirët kishin epërsi në gjashtë, por vendasit nuk dorëzohen, megjithatë vetëm ngushtuan shifrat në 82:83, pa arritur të bëjnë më shumë. Te Vëllaznimi u dalluan Cedric Council me 18 pikë e 10 kërcime, Emmanuel Emogbo me 14 pikë e 14 kërcime dhe Robert Shestani me 18 pikë e 8 asistime, kurse te Trepça më i miri ishte Drilon Hajrizi me 34 pikë e 13 kërcime.

## Prishtina dhe Bashkimi në finalen e madhe

Prishtina dhe Bashkimi janë

skuatrat e kualifikuara në finalen e Kupës së Kosovës në basketboll në konkurrencën e femrave. Prishtina ka mundur në udhëtim Vëllaznimit 66:89 (20:24, 15:20, 14:19, 17:26). Skuadra prishtinase fitoi të gjithë çerekët dhe u kualifikua në finale, që do të zhvillohet më 7 shkurt në Suharekë. Te Vëllaznimu u dallua Sarah Mgbeike me 25 pikë dhe 24 kërcime, kurse te Prishtina, Enxhi Khanaj me 20 pikë e 18 kërcime dhe Alexis Tolefree me 34 pikë. Ndërkohë, ndeshje më interesante u zhvillua ndërmjet Bashkimit dhe Penzës, ku skuadra prizrenase fitoi 80:76 (22:12, 14:17, 23:15, 21:32). Vashat prizrenase fituan çerekun e parë 22:12, derisa në periudhën e dytë më të mira ishin ato mysafire 14:17. Vendaset sërish ishin më të mira në periodën e tretë 23:15. Lojë mjaft interesante u zhvillua në periudhën e fundit, ku Penza arrin të afrojë rezultatin në 72:71, megjithatë, Bashkimi ishte më i përqendruar në fund dhe triumfoi 80:76. Te Bashkimi u dallua Lejzae Davidson me 36 pikë, kurse te Penza u dalluan Gabrielle Cooper me 21 pikë e 11 kërcime Ashlie Howwel me 17 pikë dhe 13 kërcime.



## 'Final 8' i Kupës zhvillohet me tifozë

**SUHAREKË, 31 JANAR** - Organizatori i "Final 8", Golden Eagle YLLI, ka njoftuar se tifozët do të jenë të pranishëm. Ndeshjet do të zhvillohen duke iu përmbajtur rregullave kundër Covid-19 dhe kapaciteti maksimal i tifozëve që do të

lejohen të hyjnë në sallë është rreth 200 persona. "Pas përpjekjeve të shumta të Golden Eagle Yllit si organizator në bashkëpunim me Federatën e Basketbollit të Kosovës, ju njoftojmë se në ndeshjet e Vllasa & Pagesa Final

8 Kupa e Kosovës në Basketboll do të jenë të pranishëm 200 shikues. Natyrisht basketbolli luhet për shikues dhe s'kishte si të ndodhte ndryshe, në vendin ku ky sport është më shumë se sport", thuhet në njoftimin e KB Ylli.



## SHKURT

### Prishtina triumfon kundër Korona Kielce

FC Prishtina e ka mposhtur në ndeshjen miqësore skuadrën e Korona Kielce me rezultat 3-0. Vetëm katër minuta i mjaftuan Prishtinës për të kaluar në epërsi. Ishte Besnik Krasniqi që harkoi për Gentian Muçën, i cili me kokë realizoi për 1-0. Në minutën e 22-të Muça realizoi edhe golin e dytë për Prishtinën. Gjashtë minuta pa përfunduar pjesa e parë, Prapashtica e kthen topin në zonë dhe Lorik Boshnjaku realizon gol të bukur për rezultatin 3-0.

### Hertha mund ta marrë si huazim Rashicën

Milot Rashica është afër kalimit te Hertha e Berlinit. Futbollisti "dardan" mund të huazohet për gjashtë muaj në skuadrën berlineze, e cila do të jetë e detyruar ta blejë në verë, sigurisht nëse arrin të mbijetojë në Bundesligë. Rashica tashmë ka marrë një ofertë konkrete. Klubet po punojnë për ta arritur marrëveshjen që gjithçka të mbyllet brenda së hënës. Hertha ka kërkuar një sulmues të shpejtë për një kohë të gjatë dhe vushtrriasi mund të jetë zgjidhja e problemeve aktuale.

### Qorraj përforcon Vëllaznimit

Skuadra e Vëllaznimit nga Gjakova ka arritur marrëveshje me sulmuesin Florent Qorraj. Anësori Qorraj në sezonin e kaluar ishte pjesë e KF Besa. Skuadra kuqezi bën gara në Ligën e Parë të Kosovës në futboll.

### Feronikeli përfundoi përgatitjet në Shqipëri

Skuadra e Feronikelit ka përfunduar fazën përgatitore e cila zgjati rreth tri javë. Gjatë kësaj faze përgatitore "Nikli" zhvilloi katër ndeshje miqësore, në të cilat trajneri Klodian Duro pati mundësinë që të provojë lojtarë të rinj dhe mënyra të ndryshme të lojës. Faza përgatitore për pjesën e dytë të sezonit 2020-21 u zhvillua e tëra në Durrës, në pamundësi të udhëtimit më larg, shkak i kushteve që shtete të ndryshme kanë vënë si pasojë e Covidit. Feronikeli ndeshjen e parë miqësore e zhvilloi ndaj FC Egnatia, e cila përfundoi 1-0 në favor të ekipit nga Shqipëria. Takimi i dytë miqësor u zhvillua ndaj Struga Trim & Lum dhe përfundoi 1-1. Ndeshja e tretë miqësore ballafaqoi skuadrën tonë me ekipin tjetër nga Superliga e Kosovës, Trepça '89, në të cilin u realizuan gjithsej nëntë gola, duke përfunduar me rezultat 5-4, në favor të skuadrës nga Mitrovica. Ndërsa 1-1 përfundoi ndeshja ndaj Dinamo Tiranës. FC Feronikeli tani stërvitet do t'i vazhdojë në Drenas dhe kujtojmë që më 10 shkurt ka përballjen e parë në kuadër të Kupës së Kosovës ndaj Arbërisë.

## Skënderbeu shkarkon Ahamtajn

**Korçë, 31 janar** - Humbja 0-4 me Kukësin i ka kushtuar vendin e punës Julian Ahamtajt. Klubi i Skënderbeut nëpërmjet një njoftimi ka zyrtarizuar ndarjen me trajnerin

elbasanas për shkak të rezultateve të dobëta. Në 17 javët e para Skënderbeu ka marrë 2 fitore, 6 barazime dhe 9 humbje, duke u renditur në vendin e fundit me 12 pikë, aq sa Bylisi. "Ju njoftojmë se

pas një bisede mes palëve, Klubi i Futbollit 'Skënderbeu' dhe Julian Ahamtaj kanë mbyllur marrëveshjen e bashkëpunimit me mirëkuptim. Skënderbeu falënderon ish-trajnerin

bardhekuq për përkushtimin dhe punën e mirë të zhvilluar gjatë kohës që ishte në drejtimin e ekipit. I urojmë Ahmataj shumë suksese dhe fat në të ardhmen", thuhet në njoftimin e Skënderbeut.



## Laçi mposht Teutën, Shehu debuton me fitore

**LAÇ, 31 JANAR** - Laçi konfirmohet "mace e zezë" për Teutën. Ekipi durrsak nuk ia doli të kthehet me pikë nga transfertat kurbinase, pasi u mposht me rezultatin 1-0, falë golit të Mentor Mazrekajt që, sikurse me Tiranën një javë më parë, i dhuron tri pikë të çmuara ekipit të tij. Skuadra e Shpëtim Duros barazohet me pikë me Teutën, madje e lë pas me golaverazh më të mirë, duke u kthyer mes pretendenteve për titullin. Shkëndijën e parë në këtë sfidë e dha Teuta me Krasniqin në minutën e 13-të, por tentativa e sulmuesit miq, fluturimthi, përfundoi jashtë. Në të 24-n, Stivi Frashëri për pak i dhuroi një gol skuadrës kurbinase. Portieri korçar gaboi në pasim, duke ia dorëzuar Nwabuezes, por gjuajtja e tij u ndal nga Arapi. Goli që vendosi takimin u shënua në minutën 35-të nga Mentor Mazrekaj, që përfitoi nga një tjetër "dhuratë" e mbrojtjes së Teutës, duke mposhtur portierin Frashëri. Në fundin e pjesës së parë (43'), Teuta pretendoi për 11 metra pas duelit në mes të Krasniqit dhe Mustës, por për gjuqtarin Xhaja gjithçka ishte e rregullt. Ka protesta për këtë episod nga futbollistët miq. I afrohet golit të dytë Laçi me Nwabuezen, por sërish sulmuesi vendës nuk ka shënjestrën e duhur, me topin që shkoi ngjitur me shtyllën. Amerikani me origjinë nigeriane humbi mundësinë për ta mbyllur ndeshjen, teksa



në minutën e 72-të humbi penalltinë e fituar pas një dyluftimi me Arapin. Në këtë rast, Stivi Frashëri ia mohoi festën. Laçi e kontrolloi me qetësi lojën në minutat e mbetura, madje në minutën e parë shtesë, pas një harkimi të Mazrekajt, Selmani nuk ia doli ta devijonte topin drejt rrjetës në shtyllën e dytë, raporton "Supersport". Taulant Seferi gjen golin e parë në Superiore, pikërisht në sfidën debutuese të Orges Shehit në krye të Tiranës, duke i siguruar tri pikë të çmuara ekipit bardheblu, në tentativën për t'iu thyer objektivave të rëndësishme sezonalë. Tirana e nis me vrull sfidën në "Loni Popuçiu", ku Apolonisë iu desh më shumë se çerek ore lojë ta merrte veten. Të paafte Idriz Batha dhe Ernest Muçi, që në tentativat e tyre (mesfushori nga goditja e lirë) u ndalën nga e njëjta shtyllë në minutat 10' dhe 14'. Fierakët e morën dalëngadalë veten, por nuk kishin rrezikshmëri gjatë fraksionit të parë të ndeshjes, pavarësisht prej tentativave për ta rrezikuar portën e Bekajt.

Pjesa e dytë nisi rreth 10 minuta me vonesë për shkak të erës së fortë që nuk lejonte që topi të qëndronte në një vend si dhe rrezikonte shembjen e mbulesës së tribunës. Era e fortë, në fakt, ndikoi edhe në cilësinë e lojës, pasi futbollistët e të dyja skuadrave hasën vështirësi për ndërtimin e aksioneve. Pretendojnë për 11-metërsh vendësit në minutën e 74-t, me Toshevskin që ndal Mihanën brenda zonës, që për futbollistët e Apolonisë ishte me dorë. Vetëm dy minuta më vonë, Apolonia, e cili po kërkonte me ngulm fitoren, ndëshkohet nga Taulant Seferi, i cili e pati të thjeshtë ta dërgonte topin në rrjetë pas një asistimi të pavullnetshëm të Torasës. Nuk mundi të bënte asgjë Apolonia në minutat e mbetura me vërshëllimën e fundit të kryesorit që sanksionoi humbjen e dytë radhazi të fierakëve në "Loni Popuçiu". Edhe pas kësaj disfate skuadra e drejtuar nga Cammarata mbetet në vendin e tetë, me një pikë më shumë se Bylisi dhe Skënderbeu.

## Lakersat u rikthehen fitoreve

**BOSTON, 31 JANAR** - Los Angeles Lakersi është rikthyer te fitorja në NBA pas dy humbjeve të njëpasnjëshme. Kampioni në fuqi i NBA-së ka marrë fitore në "TD Garden" përballë rivalëve të tyre më të mëdhenj, Boston Celtics. Pas 48 minutave të zjarrta, në fund lakersat triumfuan me një pikë diferencë, 95:96. Anthony Davis ishte fantastik në këtë takim me 27 pikë, 14 kërcime e dy asistime. Ndërkohë basketbollisti më i mirë në NBA, LeBron James, shtoi 21 pikë, shtatë kërcime e shtatë asistime. Me pikë dyshifrore tek skuadra fituese



e mbyllën ndeshjen edhe Montrezl Harell (16), Dennis Schroder (12) dhe Kyle Kuzma me 11 pikë. Tek vendasit

Jayson Tatum me 30 pikë dhe Jaylen Brown me 28 të tjera ishin më efikasit, por që nuk i mjaftuan për fitore. Pavarësisht prej fitoreve ndaj Celticsit, Lakersi mbetet në vendin e tretë në Konferencën e Perëndimit me 15 fitore e gjashtë disfata, kurse Bostoni është në vendin e pestë në Lindje me 10 fitore e tetë humbje.

### REZULTATET

Charlotte Hornets - Milwaukee Bucks	126-114
Chicago Bulls - Portland Trail Blazers	122-123
Miami Heat - Sacramento Kings	105-104
New Orleans Pelicans - Houston Rockets	112-126

### SHKURT

#### Liverpooli e dëshiron Mustafin

Liverpooli po përballet me një krizë në repartin e mbrojtjes, pasi Virgil Van Dijk, Joe Gomez dhe Joel Matip janë të lënduar. Trajneri i kampionëve të Anglisë, Jurgen Klopp, ka konfirmuar se "Reds" do të sjellë një mbrojtës në "Anfield". Sipas mediave britanike, synim i Liverpoolit është Shkodran Mustafi. Futbollisti shqiptar ka luajtur 20 ndeshje me përfaqësuesen gjermane, nuk po gjen hapësira tek Arsenali pasi ka luajtur vetëm 45 minuta në Premierë Ligë.

#### Ramosi preferon kalimin në Premierë Ligë

Kapiteni i Real Madridit, Sergio Ramos, ende nuk e ka vazhduar kontratën me skuadrën nga Madridi dhe largimi duket shumë i mundshëm. "Mirror"-i raporton se mbrojtësi dëshiron kalimin në Premierë Ligë. Favorit për të nënshkruar me mbrojtësin është Manchester Unitedi, por në garë janë edhe Manchester City dhe Liverpooli.

#### Kessie: Ibra i godet penalltitë te Milani

Franck Kessie ka reaguar pas zërave që Zlatan Ibrahimoviçi nuk do të jetë më lojtari që merr penalltitë. Franck Kessie u bë protagonist në fitoren ndaj Bolognas, pasi shënoi nga penaltia e dytë, pasi të parën e kishte humbur Zlatan Ibrahimoviçi. Sipas statistikave, Ibrahimoviçi ka humbur pesë penaltitë nga tetë të fundit gjithsej, dhe ky është një shqetësim për të dhe skuadrën. Më parë suedezi kishte thënë se Kessie mund të jetë lojtari që merr penalltitë, por këtë e ka përgënjeshtruar vetë futbollisti. "Penaltitë janë shumë të rëndësishme për sulmuesit, nëse shënojnë ata të ndihen më mirë. Në këtë rast, në penalltinë e dytë Ibra më ka lënë vetë dhe unë e konkretizova. Është ai që godet penalltitë, varet nga ai. Nëse nuk e ndien, nganjëherë e marr unë", ka thënë Kessie.

#### Khedira largohet nga Juve, nënshkruan për Herthan

Sami Khedira i jep fund aventurës me Juventusin në Serinë A. Mesfushori gjerman, i cili ka mbetur jashtë projektit të Pirlos, tashmë mund të quhet një futbollist i Hertha Berlinit. Mesfushori do të nënshkruajë një kontratë për dy vjet e gjysmë. Khedira do të kthehet pas 11 vjetësh në Bundesligë. Mesfushori, në fakt, është larguar nga Gjermania në vitin 2010 për të kaluar te Real Madridi, ndërsa në vitin 2015 ai u bashkua Juventusit me një transferim falas. Te "Zonja e Vjetër", Khedira fitoi pesë kampionate, 3 Kupa të Italisë dhe një Superkupë Itale.

#### Zidane, afër largimit nga Reali

Gjithmonë kur Reali i Madridit regjistron rekord negativ, në media nisin të qarkullojnë lajme për një shkarkim të mundshëm të trajnerit Zinedine Zidane. Pikërisht e njëjta gjë ka ndodhur edhe këtë herë, ku madrilenët u mposhtën 2-1 nga Levante në shtëpi. "Sport" raporton se te Reali po mendohet largimi i trajnerit, për të cilin thuhet se në fund të sezonit do të shkarkohet me siguri, por ekziston mundësia që të shkarkohet edhe më herët. Madje më tej thuhet se Perezi ka gjetur edhe zëvendësuesin e francezit, i cili pritet të jetë Allegri. Ky i fundit ishte shumë afër kalimit te Roma por, sipas raportimeve të fundit, ai refuzoi ta marrë drejtimin e verdhekuqve, pasi është kandidati kryesor për stolin e Realit.

Rrallëherë ndodh që lexuesi, pasi ta ketë lexuar librin, të marrë informacion, të gjejë thellësi mendimi, shqyrtim profesional dhe njerëzor të një krijimtari filmike sikurse i merr dhe i gjen në librin e Agron Shalës. Njëjtë si Kiesłowski që i linte të hapura veprat e tij, Shala nuk pretendon të mbyllë asgjë por, duke shqyrtuar në dimensionin artistik, politik, fetar e njerëzor, hap mundësi të reja interpretimi për dekalogun e ditëve tona.

**Zymer Kelmendi**

\*\*\*

Ky libër është interpretim për dramën serike "Dekalogu" të regjisorit Krzysztof Kiesłowski, i ndërthurur me një egzegjzë të lirë autoriale të veprave të kulturave të lashta, ku nuk mungojnë as analiza psikologjike e etike që lidhen me karakteret dhe veprimet e protagonistëve të dramës, por edhe me jetën dhe besimin e shqiptarëve sot. Një libër i shkruar me një gjuhë të rrjedhshme, që me çdo fjali të shtyn ta lexosh më tutje. Konsideroj se ky libër përbën një kontribut të pasur shkencor në opusin e kritikës së veprave artistike.

**Kristë Shtufi**

\*\*\*

Një libër që zbërthen relacionet e njeriut me fenë dhe Zotin, që bazohet në një vepër filmike, por që përçohet te ne nëpërmjet urdhrave biblike. Autori në mënyrë të mprehtë dhe me delikatesë e ndërlidh temën e besimit në Zot, ekzistencën e religjioneve të shqiptarët, duke bërë ndarjen mes fesë dhe identitetit kombëtar. Shkurt, ky është një libër i shkruar me kujdes, me një gjuhë të pastër dhe krejtësisht intelektuale, e që do të duhej të lexohej nga secili.

**Fadil Sahiti**

\*\*\*

... përmes mikrobotës së Kiesłowskit, "Dekalogu" i Agron Shalës na dëshmon se mund të ringjallet metamorfoza progresive e mendjes tonë...

**Orhan Kerkezi**

\*\*\*

Kur shikohet "Dekalogu" i Kiesłowskit dhe kur lexohet libri i Shalës, kuptohet thënia se 'thjeshtësia është madhështi'.

**Daut Dauti**

AGRON SHALA | DEKALOGU | NGA MOISIU DERI TE KIEŚŁOWSKI

**AGRON SHALA**

**DEKALOGU**

『nga Moisiu deri te Kiesłowski』

ÇMIMI: 5.99 €



Daut Dauti është historian, gazetar publicist dhe prozator. Ka kryer studimet në Fakultetin Juridik në Prishtinë, ka magjstruar në West London University në degën e Studimeve Evropiane, kurse ka doktoruar në University of Leeds në shkollën e njohur të historisë të këtij universiteti.

Në fund të viteve '80 ka filluar të merret me gazetari. Shkrimet e para i ka botuar në gazetën e studentëve *Bota e re*, pastaj në revistën *Zëri*. Nga viti 1994 deri më 1999 ka qenë korrespondent i *Zërit* nga Londra. Në vitin 1999 ka filluar të punojë në redaksinë IWPR (Institute for War and Peace Reporting) dhe në këtë vit ka themeluar zyrën e këtij instituti në Prishtinë.

Nga viti 1999 deri më 2002 ka qenë sekretar dhe ndër themeluesit e Shoqatës së Gazetarëve të Kosovës dhe ka shërbyer anëtar i Këshillit Qendror të Zgjedhjeve. Gjatë vitit 2002 në institutin amerikan *Kettering Foundation* ka hulumtuar temën e mediave të pavarura dhe që nga ky vit është anëtar i ekipit hulumtues-studiuues i këtij instituti. Dauti ka punuar në disa organizata të ndryshme vendore dhe ndërkombëtare. Ka qenë dhe zëdhënës i Qeverisë së Kosovës në vitin 2005.

Daut Dauti është autor i disa librave dhe punimeve shkencore. Punimet e tij me temë nga fusha e historisë, e gazetarisë dhe e letërsisë janë botuar në mediat shqipe dhe në revista të njohura ndërkombëtare.

*Një palë këpucë në Berlin* është novela e tij e parë.

4<sup>99</sup> €




Daut Dauti  
NJË PALË KËPUCË NË BERLIN

**Daut Dauti**  
**NJË PALË KËPUCË NË BERLIN**

novelë





# Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë




[www.facebook.com/gjejpuneshpejte](http://www.facebook.com/gjejpuneshpejte)

## RESTAURANT

# SWISS TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

PRISHTINË



044 900 978 | 045 681 898

Sallon Depilimi Lume's Details

[lumesdetails](https://www.instagram.com/lumesdetails)

Mbrapa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi

## >> SHPALLJE TË VOGLA <<

► Fatijon Rexhaj shpall të pavlefshme dëftesat e kl I - IX shfmu " Dëshmorët e Kabashit " Korishë.

► Alban Gashi shpall të pavlefshme dëftesat e kl I - VIII shfmu " Luigj Gurakuqi " Nashec.

► Ramush Krasniqi shpall të pavlefshme diplomën shmlt "11 Marsi " Prizren.

► Sanel Duraku shpall të pavlefshme dëftesat dhe diplomën shme " Ymer Prizreni " Prizren.

► Aida Ilijazi shpall të pavlefshme dy dëftesat dhe diplomën shmlt "11 Marsi " Prizren.

► Doruntina Zogiani shpall të humbur diplomën e Fakultetit të FSHMN-së drejtimi Fizikë -arsimore, në Universitetin e Prishtinës "Hasan Prishtina", data e lëshimit diplomës 12 shkurt 2007.

► Jap banesë me qira afër 60 m2, kati III-Lagja Mati 1 Rr.Z3-Si Theodor Muzaka nr.14. në Prishtinë. Banesa posedon dhoma gjumi dhe sallon, kuzhinë, korridor banjo ballkon . Banesa është e mobiluar komplet, preferoj ta jap banesën me qira për afat të gjatë. Tel: +38344185233.

► Lëshoj banesë me qira në lagjen "Dardania" në Prishtinë. Banesa ka 50 m2, me inventar të kompletuar, banesa ka kuzhinë me sallon, teras, banjo një dhomë gjumi, shpajz dhe korridor, banesa lëshohet për një qift ose për dy vajza. Tel: 044171328.

► Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkujdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërlllok, Tel: 044-608-626.

► Lëshoj banesë me qira për student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muharrem Fejza", banesa është 70 m2 dhe i plotëson të gjitha kushtet, kati dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Fejza" Prishtinë. Tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qira në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 €uro. Tel: 044-185-233.

► Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.

► Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.

► Urgjentisht kërkohet një banesë me qira në Prishtinë. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188

► Lëshoj lokalim me qira. Lokali është i pasitur me të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275

► Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

► Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

► Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes , sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

► Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.

► Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

► Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

► Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

► Lëshoj banesën e re me qira në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 €uro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)

► Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë numër të tel: 049-440-466.

► Lëshoj banesën një dhomshe me qira , ne lagjen Dardania afër Postës Kryesore (posta e Madhe) Kroj i Bardhe, banesa është e mobiluar tërësisht. Për informata lajmërohuni në tel: 044/558-894 Prishtinë.

► Lëshoj me qira banesën e mobiluar te salloni i mobileve "ALBED" në Fushë Kosovë. Banesa i ka 65 metra katrorë dhe është e gatshme për banim. Më shumë informata në: 044/706-079.

► Lëshoj banesën me qira në lagjen "Ulpiana" në Prishtinë, afër AAK-së. Banesa është e mobiluar komplet. Për informata mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 044-162-783, si dhe në të njëjtin numër në viber.

► Kërkojmë 4 bashkëbanuese, studente, banesa gjendet te Parku i qytetit, kati i I-rë, ka 3 dhoma, banjo , ballkon, çmimi për person është 50 euro plus shpenzimet . Për info: 045/699-221.

► Lëshohet me qira banesa në lagjen Bregu i Diellit te furra Qërimi 2. Banesa është në katin e tretë, ka sallon dhe kuzhinë si dhe dy dhoma të fjetjes. Numri i telefonit: 044 332 640.



## ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

### Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comercio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

